



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 248 Vendimi

Tiranë, më 5.3.2020

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Etleđa Çiftja</b>	<b>Relatore</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, sot në datën 5.3.2020, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Marjana Shtjefni, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016,** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015,** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 96/2016,** “Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë”.

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2020, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i është njoftuar vendimi nr. \*\*\*, datë 26.12.2019, “Për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes”. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, në datën 19.12.2019, të znj. Marjana Shtjefni, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2020, i kërkoi Këshillit të Lartë të Prokurorisë praktikën/dosjen e plotë (të gjithë dokumentacionin shkresor), mbi bazën e të cilit është marrë vendimi i sipërcituar, si dhe të informojë nëse ndaj këtij vendimi subjekti ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
3. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar subjekti ka depozituar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2019, për mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes.
4. Komisioni vëren se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në germën “a”, të pikës 1, të nenit 64, dhe të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në germën “a”, të pikës 1, të nenit 189, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u njoh me dorëheqjen nga detyra të znj. Marjana Shtjefni, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
5. Gjithashtu, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka konfirmuar marrjen në dijeni të këtij vendimi nga subjekti i rivlerësimit, si dhe faktin se ky subjekt nuk ka paraqitur ankim kundra tij në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Për sa më sipër, Komisioni vëren se konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi znj. Marjana Shtjefni ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe pasi ky Këshill ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi, i cili ka marrë formë të prerë.
7. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2019, mbledhja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka vendosur ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit, për një periudhë 1-vjeçare. Trupi gjykues, i shortuar për këtë qëllim, është i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Lulzim Hamitaj.

## **II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

8. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”
9. Pika 3, e nenit 179/b, të Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.
10. Trupi gjykues konstaton se znj. Marjana Shtjefni ka qenë me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.
11. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, në datën 31.1.2020, të znj. Marjana Shtjefni, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
12. Kolegji i Posaçëm Apelimit, në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën e ndryshme të tij, po

kështu dhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

13. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare<sup>1</sup>.

14. Për sa më sipër, Komisioni vëren se konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi znj. Marjana Shtjefni ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe pasi ky Këshill ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.

### **Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit**

15. Në germën “a”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

16. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

*“a. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para këshillit përkatës.*

*b. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinim me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.*

*c. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.”*

17. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

*“a. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*b. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

---

<sup>1</sup> Referojuni vendimit nr. 1/2018 (JR), datë 11.6.2018, të KPA-së dhe paragrafëve 96 dhe 97 të tij.

18. Neni 56, i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

*“a. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.*

*b. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit ‘Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit’”.*

19. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

*“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*

20. Me paraqitjen e kërkesës nga subjekti i rivlerësimit dhe me shkresën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Shtjefni “nga funksionet e magjistratit” dhe të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për mbarimin e këtij statusi në datën 31.1.2020. Gjithashtu, Komisioni mori dijeni edhe të faktit se subjekti nuk ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi.

21. Në këto kushte, referuar fakteve të evidentuara më lart, trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjana Shtjefni, duhet të ndërpritet, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

22. Në zbatim të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t’u dëgjuar, në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji (germa “d” e tij). Duke qenë se neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon ndërprerjen në rast dorëheqjeje nga detyra, ndërprerja e procesit bëhet pa u zhvilluar seanca dëgjimore.

23. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marjana Shtjefni, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 5.3.2020.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
**Kryesuese**

**Etleda Çiftja**  
**Relatore**

**Lulzim Hamitaj**  
**Anëtar**

*Olsida Goxhaj*  
*Sekretare gjyqësore*